

BARKODI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "TEKNOLOGJI BUJQËSORE"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

-
1. Në sitemin e ftohjes te MDB, Termostati ka për qëllim të: **1 pikë**
- A) Të sigurojë ndezjen fillestare
 - B) Të komandojë qarkullimin e ujit ne MDB në funksion të temperaturës
 - C) Të sigurojë fikjen e motorrit
 - D) Të gjitha më sipër
2. Përzierja e lëndës djegëse në MDB me benzinë realizohet: **1 pikë**
- A) Jashtë cilindrit
 - B) Brenda në cilindër
 - C) Në depozitën e lendës djegëse
 - D) Të gjitha më sipër
3. Sistemi i vajosjes ne MDB shërben: **1 pikë**
- A) Për uljen e forcave te fërkimit
 - B) Për ftohjen e motorit
 - C) Për pastrimin e motorit
 - D) Të gjitha mësipër
4. Motorino është pjesë përbërëse e: **1 pikë**
- A) Qarkut të ndezjes së MDN
 - B) Sitemit te ftohjes së MDB
 - C) Sitemit të vajsjes në MDB
 - D) Qarkut te injektimit te naftes
5. Mekanizmi i bujqësisë shërben për: **1 pikë**
- A) Rritjen e prodhimit nga saktësia e punës me makina
 - B) Shkurtimin e kohës së punës
 - C) Uljen e kostos së prodhimit
 - D) Të gjitha më sipër
6. Në transmisionet me rripa, transmetimi i lëvizjes realizohet nëpërmjet: **1 pikë**
- A) Presionit hidraulik
 - B) Forcave të fërkimit
 - C) Ingranimit
 - D) Asnjë me sipër
7. MDB sipas mënyrës si realizohet cikli i punës klasifikohen: **1 pikë**
- A) Motor Diesel dhe Motor Otto (me karburator)
 - B) Motor endotermik
 - C) Motor me 4 kohë dhe Motor me 2 kohë
 - D) Motor egzotermik
8. Harxhimi i lëndës djegëse në një MDB me fuqi të njëjtë është më i madh në një: **1 pikë**
- A) Motor Diesel
 - B) Motor Otto (me karburator)
 - C) Motor elektrik
 - D) Të gjitha njësoj
-

9. Boshti i marrjes së fuqisë (B.M.F) e traktorit është bosht: **1 pikë**
- A) me kiaveta
 - B) me fileto
 - C) me shlica
 - D) me saldim
10. Friksioni ne traktorin bujqësor shërben: **1 pikë**
- A) Për vënien në punë te ngritësit hidraulik
 - B) Për dhënien ose ndërprerjen e lëvizjes rrotulluese të boshtit të motorit në kutine e shpejtësisë
 - C) Për ndezjen e MBD
 - D) Për injektimin e lëndës djegëse
11. Ngritësi hidraulik shërben për të: **1 pikë**
- A) Lidhur plugun e varur me traktorin bujqësor
 - B) Për të rregjistruar për punë plugun
 - C) Për ngritjen dhe fiksimin e plugut te varur ne gjendje transporti
 - D) Të gjitha më sipër
12. Pajisja lidhëse-tërheqëse dhe çengeli tek traktorët bujqësorë shërben: **1 pikë**
- A) Për të transmetuar lëvizje rrotulluese tek organet punuese të makinave të punës
 - B) Për të transmetuar lëvizje rrotulluese tek organet lëvizëse (rrotat) e traktorit Për të transmetuar lëvizje drejtvizore tek organet lëvizëse (rrotat) e traktorit
 - C) Për të lidhur, rregjistruar dhe terhequr te gjitha makinat e punues të terhequra dhe rimorkiot
 - D) Për të lidhur, rregjistruar dhe terhequr te gjitha makinat e punues të varura dhe rimorkiot
13. Organet punuese te frezes, rotorit (boshti dhe thikat) gjatë procesit te punës e kryejnë lëvizje: **1 pikë**
- A) Drejtvizore
 - B) Rrotulluese
 - C) Të përbërë, drejtvizore + rrotulluese
 - D) Asnjëra prej tyre
14. Gjatë procesit të punës një makinë mbjellëse me saktësi realizon hedhjen e farës: **1 pikë**
- A) Me distancë nga rreshti në rresht dhe ne forme zinxhiri brenda rreshtit
 - B) Në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë siperfaqen
 - C) Me distancë nga rreshti në rresht dhe nga bima në bimë brenda rreshtit
 - D) Të kryejë në të njëjtën kohë të gjitha më sipër
15. Gjatë realizimit të procesit të mbjelljes së grurit makina mbjellëse realizon hedhjen e farës me distancë nga rreshti në rresht: **1 pikë**
- A) 30 cm
 - B) 15 cm
 - C) 45 cm
 - D) 70 cm

16. Detyrat kryesore që duhet të kryejë një makine plehruese janë: **1 pikë**
- A) Të sigurojë shpërndarjen në sipërfaqe të normës së përcaktuar të plehut që do të hidhet
 - B) Shpërndarjen e plehut në mënyrë të njëtrajtshme
 - C) Mbulimin e plehrave në toke (jo në të gjitha rastet)
 - D) Të gjitha më sipër
17. Sasia e farës që hidhet nga një aparat shpërndarës mekanik (me bobine me kanale) në një makinë mbjellëse me rreshta varet nga : **1 pikë**
- A) Ndryshimin e gjeresisë punuese ose/dhe shpejtësisë rrotulluese të bobinës
 - B) Ndryshimin e thellësisë së mbjelljes
 - C) Ndryshimin e shpejtësisë rrotulluese të përzierësit të arkës së farës
 - D) Ndryshimin e llojit të arkës së farës
18. Përcaktoni cila pjesë e makines mbjellëse siguron drejtimin nga traktoristi gjatë procesit të mbjelljes në mënyrë që të ruhet drejtimi i rreshtave dhe të sigurohen gjerësi të barabarta të midis rreshtave të formuara nga dy ose më shumë kalime të makinës: **1 pikë**
- A) Rrotat e makinës
 - B) Shënuesi
 - C) Aparati dozues
 - D) Arka e farës
19. Në një makinë spërkatëse me aparat shpërndarës me pluhurizim hidraulik sasia e lëndës helmuese që hidhet tek bimët është në funksion të: **1 pikë**
- A) Diametrit të vrimave të kalibruara (të sprucatorit) dhe presionit të rrymës së ajrit
 - B) Diametrit të vrimave të kalibruara (të sprucatorit) dhe presionit të lëngut helmues
 - C) Vetëm diametrit të vrimave të kalibruara (të sprucatorit)
 - D) Vetëm presionit të lëngut helmues
20. Shpejtësia e badiatorit (rrotullime/sek) duhet të jetë më e madhe për kulturat: **1 pikë**
- A) Grurë, elb, tërshërë
 - B) Bathë, sojë, luledielli
 - C) Oriz, fshesë, tep
 - D) Jonxhë, tërfil

21. Sipas llojit të materialit që shpërndahet dhe gjendjes fizike të tij makinat për shpërndarjen e plehrave dhe përmisuesve i klasifikojmë: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

22. Në një makinë mbjellëse me zhardhok procesi i punës përfshin: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

23. Listoni katër tipe të aparatave spërkatëse bazuar në parimin e funksionimit (pluhurizimit të lëngut): **4 pikë**


- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

24. Identifikoni tipin e makinës të paraqitur në figurë _____ **1 pikë**

Plotësoni emërtimet e pjesëve të makinës ku është vendosur ?:

a. _____ b. _____ c. _____ **1 pikë**

Shpjegoni cilat janë detyrat që duhet të kryejë makina gjatë punës. **2 pikë**



25. Punimet e tokës përbëjnë fazat e para dhe nga më të rëndësishmet në teknologjinë e kultivimit të bimëve, për të krijuar një gjendje fizike të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e bimëve bujqësore. Listoni 4 arsye pse duhet të bëhet punimi i tokës: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

26. Listoni 4 organe punuese të pjesës korrëse të autokombajnës. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Lidhjet e detaleve në makineritë klasifikohen në lidhje të zbrërthyeshme dhe lidhje të pazbrërtheshme. Plotësoni në cilin grup hyjnë lidhjet e mëposhtme: **4 pikë**

- Lidhjet me fileto (bulona dhe dado) _____
- Lidhjet me saldim _____
- Lidhjet me shlica _____
- Lidhjet me kiaveta _____

28. Një motor diezel (me naftë) dallon me një motor me karburator (me benzinë) në disa drejtime. Përcaktoni i kujt tipi motori është karakteristika e mëposhtme: **4 pikë**

- Ndot mjedisin më pak _____
- Realizon përzierjen jashtë cilindrit _____
- Karburanti vetëndizet _____
- Karburanti ka çmimin më të lartë _____

29. Listoni cilat janë pajisjet të punës së traktorëve bujqësorë që shërbejnë për të lidhur, regjistruar dhe transmetuar lëvizjen nga traktori bujqësor tek makinat punuese: **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

30. Është dhënë një makinë mbjellëse me 13 rreshta që do të realizojë mbjelljen e Grurit në distance 15 cm nga rreshti në rresht. Duke ditur që gjatësia e dobishme e makines është distanca nga nga brazdari para deri në brazdarin e fundit dhe gjatësia kapëse është distanca nga rrota në rrotë e makinës mbjellëse llogarisni:

- Gjatësinë dobishme të Makinës Mbjellëse _____ **1 pikë**
- Ndërtoni skemën e vendosjes së brazdarëve (ripuntatorëve) **3 pikë**

